

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ndërmjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Portugalisë

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, dhe **Këshilli i Lartë Gjyqësor i Republikës së Portugalisë**, i përfaqësuar nga Zëvendëskryetari, z. Luis Azevedo Mendes, në vijim individualisht, i referuar si “Palë” dhe kolektivisht si “Palët”;

duke synuar forcimin e mëtejshëm të marrëdhënies së miqësisë, mirëkuptimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit institucional ndërmjet institucioneve përkatëse;

duke njohur rëndësinë e promovimit të administrimit të duhur të drejtësisë, integritetit institucional, llogaridhënies, profesionalizmit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve gjyqësore;

duke vlerësuar rëndësinë e shkëmbimit të përvojës, ekspertizës dhe praktikave më të mira në fushat që lidhen me inspektimet, verifikimet disiplinore, hetimet disiplinore dhe çështje të tjera me interes të përbashkët;

duke marrë parasysh nevojën për të garantuar që ky bashkëpunim të zhvillohet në përputhje të plotë me pavarësinë e gjyqësorit, kompetencat kushtetuese dhe ligjore të secilit institucion, si dhe me rregullat në fuqi që rregullojnë konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave dhe sekretin profesional;

kanë arritur mirëkuptimin si më poshtë vijon:

NENI 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (në vijim “Memorandumi”) është të krijojë një kuadër bashkëpunimi ndërmjet Palëve në fushat e inspektimeve gjyqësore, hetimeve disiplinore dhe çështjeve të tjera me interes të ndërsjellë, që lidhen me organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit.

2. Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi synon, në veçanti:

- a) të promovojë shkëmbimin dhe zhvillimin e praktikave më të mira, metodologjive, standardeve dhe instrumenteve, që lidhen me inspektimet gjyqësore, mbikëqyrjen, monitorimin dhe vlerësimin;
- b) të lehtësojë ndarjen e përvojës dhe të qasjeve në lidhje me fillimin, zhvillimin dhe ndjekjen e hetimeve dhe procedimeve disiplinore, ndaj gjyqtarëve;

- c) të nxisë standarde të larta të sjelljes profesionale, etikës dhe integritetit brenda gjyqësorit;
- d) të mbështesë trajnimin, zhvillimin profesional dhe ngritjen e kapaciteteve, në fushat që mbulohen nga ky Memorandum;
- e) të trajtojë çdo çështje tjetër, që Palët mund të konsiderojnë bashkërisht si të rëndësishme.

NENI 2

Parimet e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) respektimi i pavarësisë së gjyqësorit dhe i autonomisë institucionale të secilës Palë.
- b) respektimi i kuadrit kushtetues, ligjor dhe rregullator, që rregullon veprimtarinë e secilës Palë.
- c) reciprociteti, besimi i ndërsjellë dhe përfitimi i ndërsjellë.
- d) mirëbesimi, matura dhe konfidencialiteti.
- e) respektimi i plotë i legjislacionit të brendshëm të zbatueshëm të secilit shtet dhe i detyrimeve përkatëse ndërkombëtare.

NENI 3

Fushat e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi mund të mbulojë, ndër të tjera, fushat e mëposhtme:

1. Inspektimet dhe mbikëqyrja:
 - a. modelet institucionale dhe kuadrin ligjor për inspektimin dhe mbikëqyrjen e gjykatave dhe të gjyqtarëve;
 - b. planifikimin, zhvillimin dhe raportimin mbi inspektimet e rregullta dhe ato ad hoc;
 - c. kriteret e vlerësimit dhe treguesit e performancës për gjykatat dhe gjyqtarët, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm për secilën Palë;
 - d. përdorimin e mjeteve digjitale, sistemeve të informacionit dhe të dhënave për qëllime inspektimi, mbikëqyrjeje dhe monitorimi.
2. Hetimet dhe procedimet disiplinore:
 - a. kuadrin ligjor, standardet dhe procedurat, që rregullojnë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve.
 - b. teknikat për konstatimin e fakteve, vlerësimin e provave dhe hartimin e raporteve, rekomandimeve dhe vendimeve në çështjet disiplinore;
 - c. garancitë për pavarësinë e gjyqësorit, procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat për një gjykim të drejtë në procedimin disiplinor;
 - d. sistemet e menaxhimit të çështjeve dhe monitorimin statistikor të çështjeve disiplinore.

3. Etika profesionale dhe integriteti:

- a. kodet e sjelljes gjyqësore dhe udhëzimet etike;
- b. parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit;
- c. vlerësimin e rreziqeve për integritetin dhe masat për zbutjen e tyre.

4. Zhvillimi institucional dhe qeverisja:

- a. strukturat organizative dhe procedurat e brendshme të Palëve;
- b. menaxhimin e burimeve njerëzore, politikat e trajnimit dhe vlerësimin e performancës së personelit të përfshirë në inspektime, hetime dhe veprimtari disiplinore;
- c. planifikimin strategjik, strategjitë e komunikimit dhe marrëdhëniet me autoritete të tjera gjyqësore dhe publike.

5. Fusha të tjera me interes të përbashkët:

Çdo çështje tjetër që lidhet me kompetencat e Palëve dhe që, me pëlqim të ndërsjellë, mund të identifikohet si fushë me interes të përbashkët.

NENI 4

Format e Bashkëpunimit

1. Për të arritur objektivat e këtij Memorandumi, Palët mund, në varësi të kompetencave të tyre përkatëse, kuadrit ligjor dhe burimeve në dispozicion, të bashkëpunojnë, ndër të tjera, nëpërmjet:

- a) shkëmbimit të informacionit, dokumentacionit, analizave dhe studimeve të rasteve jo-konfidenciale, përfshirë legjislacionin, rregulloret e brendshme, udhëzimet, manualët, raportet dhe statistikat.
- b) vizitave studimore, ndjekjes së veprimtarisë praktike dhe shkëmbimeve afatshkurtra të stafit.
- c) organizimit të përbashkët të workshop-eve, seminareve, konferencave dhe aktiviteteve trajnuese për inspektorë, gjyqtarë dhe personel tjetër përkatës.
- d) takimeve tematike të ekspertëve dhe grupeve të punës, përfshirë në fushat e digjitalizimit, analizës së të dhënave dhe çështjeve të reja në praktikën e inspektimit dhe të disiplinës.
- e) zhvillimit të projekteve dhe nismave të përbashkëta ose të koordinuara, kur është e përshtatshme, përfshirë, kur vlerësohet e dobishme, edhe në bashkëpunim me partnerë të tjerë kombëtarë ose ndërkombëtarë.
- f) çdo forme tjetër bashkëpunimi të dakordësuar ndërmjet Palëve.

2. Veprimtaritë konkrete, përfshirë objektin e tyre, afatet kohore, vendet e zhvillimit dhe rezultatet e pritshme, mund të përcaktohen më hollësisht në marrëveshje të veçanta zbatimi, plane pune ose programe aktiviteteve të dakordësuara ndërmjet Palëve.

NENI 5
Pikat e Kontaktit

1. Palët caktojnë si pika përkatëse të kontakti të tyre:

(i) Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë:

(ii) Për Këshillin e Lartë Gjyqësor:

Eljona Bylykbashi

Margarida Sousa

Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike

Inspektorja Koordinuese

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina
13, Tiranë, Shqipëri

Rua Duque de Palmela, 23 1250-097 Lisboa,
Portugal

eljona.bylykbashi@ild.al

margarida.p.sousa@csm.org.pt

2. Pikat e kontaktit të caktuara do të bashkërendojnë ndërmjet tyre planifikimin, koordinimin dhe ndjekjen e aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të këtij Memorandumi.

3. Çdo ndryshim në caktimin e një pike kontakti do t'i komunikohet me shkrim Palës tjetër pa vonesë të pajustificuar.

NENI 6
Konfidencialiteti

1. Palët do ta trajtojnë si konfidencial çdo informacion të shkëmbyer sipas këtij Memorandumi që, për nga natyra, përmbajtja ose shënimi i shprehur, duhet të konsiderohet si i tillë.

2. Ky informacion nuk mund t'u bëhet i ditur palëve të treta dhe as të përdoret për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në këtë Memorandum, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës që e ka vënë në dispozicion, përveç rasteve kur përhapja -kërkohet nga ligji i zbatueshëm.

3. Asnjë dispozitë e këtij Memorandumi nuk do të interpretohet si detyrim për cilëndo Palë për të përhapur informacion, nëse përhapja do të binte ndesh me legjislacionin e saj të brendshëm, rregullat institucionale, detyrimet ligjore për konfidencialitet ose ushtrimin e rregullt të funksioneve të saj.

NENI 7
Mbrojtja e të Dhënave Personale dhe Sekretit Profesional

1. Çdo shkëmbim ose përpunim i të dhënave personale në kuadër të këtij Memorandumi do të kryhet në përputhje me ligjin e brendshëm të zbatueshëm për secilën Palë dhe me parimet përkatëse të mbrojtjes së të dhënave personale në fuqi në sistemet juridike përkatëse.

2. Ky Memorandum do të zbatohet pa cenuar detyrimet që lidhen me sekretin profesional, konfidencialitetin, sekretin gjyqësor, mbrojtjen e hetimeve në zhvillim ose çdo detyrim tjetër ligjor për konfidencialitetin që lidh secilën Palë dhe titullarët e saj, gjyqtarët, inspektorët, anëtarët e personelit ose bashkëpunëtorët.

NENI 8

Kostot dhe Burimet

1. Përveçse, nëse vendoset ndryshe me shkrim, secila Palë do të mbulojë kostot dhe shpenzimet që i linden nga zbatimi i këtij Memorandumi.

2. Ky Memorandum nuk përbën angazhim financiar apo detyrim juridik për asnjërën Palë për të financuar ndonjë aktivitet.

3. Palët mund, rast pas rasti dhe në varësi të procedurave të tyre të brendshme dhe disponueshmërisë buxhetore, të shqyrtojnë mundësi për mbështetje të ndërsjellë teknike ose logjistike për aktivitete specifike.

4. Asnjëra Palë nuk do të kërkojë nga tjetra rimbursim të shpenzimeve që rrjedhin nga zbatimi i këtij Memorandumi, përveç rasteve kur paraprakisht është arritur një marrëveshje e posaçme me shkrim.

NENI 9

Statusi Juridik

1. Ky Memorandum pasqyron synimin e përbashkët të Palëve për të bashkëpunuar në çështjet e përcaktuara në të.

2. Ky Memorandum nuk krijon detyrime ligjore të detyrueshme sipas së drejtës ndërkombëtare dhe nuk mund të interpretohet si kufizim, ndryshim ose shkelje e kompetencave, prerogativave ose përgjegjësisë ligjore të ndonjë Palë.

3. Çdo projekt ose aktivitet specifik që Palët mund të dëshirojnë të zhvillojnë në kuadër të këtij Memorandumi mund, kur është e nevojshme, të rregullohet me marrëveshje të veçanta me shkrim.

NENI 10

Zbatimi, Rishikimi dhe Plani i Punës

1. Palët mund të takohen, sa herë që e konsiderojnë të përshtatshme, për të shqyrtuar zbatimin e këtij Memorandumi, për të vlerësuar ecurinë e bashkëpunimit dhe për të shqyrtuar forma ose fusha të reja bashkëpunimi.

2. Me qëllim lehtësimin e ndjekjes së aktiviteteve të ndërmarra sipas këtij Memorandumi dhe identifikimin e mundësive të reja për bashkëpunim, Palët mund të hartojnë së bashku një plan pune vjetor.

3. Çdo plan i tillë pune do të ketë natyrë orientuese dhe operacionale dhe nuk do të krijojë në vetvete, detyrime ligjorisht të detyrueshme për asnjërën Palë, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe me shkrim.

NENI 11

Ndryshimet

Ky Memorandum mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve. Çdo ndryshim do të hyjë në fuqi në datën e dakordësuar ndërmjet Palëve.

NENI 12

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi do të zgjidhet në mënyrë miqësore, nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve.

NENI 13

Hyrja në Fuqi, Kohëzgjatja dhe Përfundimi

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët.
2. Ky Memorandum do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar, përveç rastit kur njëra Palë e njofton me shkrim Palën tjetër për qëllimin e saj për ta përfunduar atë.
3. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Memorandum duke i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim të paktën 90 ditë përpara.
4. Përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikojë në vijimësinë e ndonjë aktiviteti ose nisme që është nisur tashmë me pëlqimin e ndërsjellë, përveç në rast se Palët bien dakord ndryshe.

NENI 14

Gjuhët

1. Ky Memorandum hartohet në gjuhën shqipe, angleze dhe portugeze, ku të tre tekstet janë njëllëj autentike.
2. Në rast të ndonjë mospërputhjeje interpretimi ndërmjet versioneve angleze, shqipe dhe portugeze të këtij Memorandumi, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

Nënshkruar në Lisbonë, më 26 mars 2026, në tri kopje origjinale, në gjuhën shqipe, angleze dhe portugeze, ku secila Palë mban një set origjinal.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së
Republikës së Shqipërisë

Këshilli i Lartë Gjyqësor i Republikës së Portugalisë

Artur Metani

Inspektor i Lartë i Drejtësisë

Luís Azevedo Mendes

Zëvendës-presidenti

